

A background network diagram consisting of numerous light blue circular nodes of varying sizes connected by thin, light gray lines. The nodes are distributed across the page, with a higher density in the upper right and lower right areas. A large, solid light blue semi-circle is positioned in the bottom right corner, partially overlapping the network lines.

RRJETI I SHËRBIMEVE **SOCIO-SHËNDETËSORE**

● Bashkia Fier

RRJETI I
SHËRBIMEVE
SOCIO-SHËNDETËSORE

Bashkia **Fier**

Informacioni u mblodh nga
Qendra “Epoka e Re”, Fier



Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti u realizua me mbështetjen e
Projektit “Shëndet për të Gjithë” të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe
Bashkëpunim SDC”.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**



Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	5
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Bashkia Fier	6
Zyrat Sociale të Njësive Administrative të Bashkisë Fier	10
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Fier	14
Njësia e Shërbimit Paliativ dhe Kimioterapisë, Spitali Rajonal Fier	18
Qendra e Ndhmës Juridike Parësore, Fier	20
Qendra Komunitare Multifunktionale, Bashkia Fier	22
Shtëpia e të Moshuarve – Shërbim rezidencial kombëtar	24
Qendra Horizont - Shërbime për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi ndryshe	26
Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Fier	28
Qendra “Me një ndalesë”	30
Motrat “Bijat e Shën Françeskut të Asisit” - Shërbim infermieror në banesë	32
Qendra Sociale Murialdo – Shërbime ditore passhkollore për fëmijët 5-10 vjeç	34
Qendra Sociale Murialdo - <i>Formim profesional, integrim social dhe mundësi zhvillimi për të rinjtë dhe komunitetet</i>	36
Qendra “Platforma Kombëtare për Gratë” (PKG)	40
Shoqata SELAM	42
Qendra Rinore “Epoka e Re”	44
Kisha Katedrale Ortodokse “Shën Gjergji”, Fier	46
Fondacioni ICF, Fier (International Christian Fellowship)	48

Hyrje

Rrjeti i Shërbimeve Socio-Shëndetësore në Bashkinë Fier është një nismë e mbështetur nga Projekti “Shëndet për të Gjithë” i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në zbatim të “Strategjisë Kombëtare të Kujdesit Shëndetësor Parësor” 2020-2025. Dokumenti synon të fuqizojë shërbimin socio-shëndetësor në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP) përmes përmirësimit të qasjes dhe cilësisë së shërbimeve sociale, veçanërisht të atyre që synojnë arritjen e popullatave të cenueshme.

Ky dokument përbën një mjet pune që u vjen në ndihmë punonjësve socialë pranë KSHP-së për të lidhur ose referuar pacientët drejt shërbimeve plotësuese, që nuk mund të ofrohen nga Qendrat Shëndetësore. Njëkohësisht, dokumenti u vjen në ndihmë aktorëve të tjerë lokalë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore, si Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Fier, duke u mundësuar njohjen dhe koordinimin më të mirë të shërbimeve në zonën e tyre të mbulimit.

Rrjeti i Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale në Bashkinë Fier u përgatit gjatë periudhës kohore tetor 2024 – shkurt 2025, nga Qendra “Epoka e Re”, Fier.

Për realizimin e këtij dokumenti, falendërojmë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashki, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Shërbimet e tjera publike dhe jopublike, si edhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Fier, si bashkëpunëtorë të rëndësishëm në jetësimin e këtij procesi.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Bashkia Fier

Lloji i institucionit Publik

Adresa Lagjja Kastriot, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier
Email: info@bashkiafier.gov.al

Përfaqësues ligjor i institucionit **Merita Bitri**
Cel.: 00355 69 23 77 506 | Email: merita.bitri@sherbimisocial.gov.al

Personi i kontaktit **Merita Bitri**
Cel.: 00355 69 23 77 506 | Email: merita.bitri@sherbimisocial.gov.al

Mbulimi gjeografik Bashkia Fier, në 13 njësitë administrative (9 rurale dhe 4 urbane)

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 1991

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

➤ Të kontribuojë në fuqizimin dhe integrimin e grupeve të pafavorizuara në Bashkinë Fier.

Fushat e shërbimeve

- Planifikim, administrim dhe monitorim i shërbimeve sociale në bashkinë Fier.
- Koordinim i shërbimeve parashoqërore, multifunksionale, shërbimeve të punësimit, edukimit, rehabilitimit fizik e psikologjik dhe të këshillimit ligjor.

Llojet e shërbimeve

- Koordinon funksionimin e Grupit Teknik Multidisiplinor (GTM) për rastet e fëmijëve në rrezik.
- Koordinon funksionimin e Ekipit Teknik Multidisiplinor (ETN) për rastet e dhunës në familje.
- Koordinon “Shërbimin e urgjencës për rastet e dhunës në familje”.
- Evidenton nevojat e grupeve vulnerabël që trajton përmes vlerësimit të gjendjes reale socio-ekonomike.
- Monitoron dhe menaxhon rastet e fëmijëve viktime të dhunës, abuzimit dhe keqtrajtimit.
- Shërben si qendër informacioni për grupet e synuara vulnerabël
- Realizon përzgjedhjen e përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike (NE) dhe bën shpërndarjen e pagesave të NE-së.
- Jep informacion mbi dokumentacionin e nevojshëm për t’u regjistruar në azilet e të moshuarve dhe mbledh, shqyrton dhe paraqet dosjet në Këshillin Bashkiak, Fier.

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Të rriturit
- Të moshuarit
- Gratë dhe vajzat
- Familjet

Kriteret kualifikuese

Fëmijët

- Fëmijë jetimë
- Fëmijë në situatë rruge ose në konflikt me ligjin

Të rriturit /Individë

- Persona me aftësi të kufizuar
- Invalidë të punës (sipas vlerësimit nga Komisioni Mjekësor për Caktim të Aftësisë për Punë të Invalidëve (KMCAP)
- Persona subjekte të diskriminimit dhe dhunës
- Të papunë

Të moshuarit

- Të moshuar mbi 65 vjeç
- Të moshuar të vetmuar
- Të moshuar në kushte të vështira ekonomike, sociale
- Të moshuar pa pasuri dhe prona

Gratë dhe vajzat:

- Gra dhe vajza viktime të dhunës në familje (dhe fëmijët e tyre) të pajisur ose jo me urdhër mbrojtjeje
- Gra dhe vajza në vështirësi sociale dhe ekonomike

Familjet:

- Familje në vështirësi ekonomike dhe sociale

Identifikimi i përfituesve

Përmes:

- Mekanizmit të koordinuar të referimit (përfshirë administratorët socialë)
- Referimit nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë
- Referimit nga institucione të tjera lokale publike dhe private
- Referimit nga organizata të shoqërisë civile
- Referimit nga komuniteti

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 19 punonjës (1 drejtor; 1 financier; 2 punonjës për barazinë gjinore dhe dhunën në familje; 2 punonjës për mbrojtjen e fëmijës; 13 punonjës socialë për të gjitha njësitë administrative)

Financuesi i shërbimit	➤ Bashkia Fier (buxheti i bashkisë) ➤ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Burime të tjera të ardhurash	➤ Donatorë si, UNDP, TDH, EU, Këshilli i Europës
Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka
Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Qarku Fier ➤ Qendra Multifunksionale Horizont ➤ Qendrat Shëndetësore, Bashkia Fier ➤ Qendrat e Emergjencës, Spitali Rajonal Fier ➤ Zyra e Punës dhe Formimi Profesional, Fier ➤ Zyra Vendore Arsimore, Fier ➤ Qendrat komunitare ➤ Drejtoria Vendore e Policisë, Fier ➤ Gjykata Fier ➤ Shërbimi Ligjor Falas, Bashkia Fier ➤ Shtëpia e të Moshuarve në varësi të Bashkisë Fier ➤ Organizata të Shoqërisë Civile

O Zyrat Sociale të Njësive Administrative të Bashkisë Fier

Shënim: Në këtë fishë do të listohen Njësitë Administrative në Bashkinë Fier dhe kontaktet e administratorëve socialë. Rolet, detyrat dhe funksionet e administratorëve socialë janë të njëjta në të gjitha Njësitë Administrative në Bashkinë Fier.

Lloji i institucionit Publik

- Adresa** ➤ Qyteti Fier
➤ Njësia Administrative Cakran
➤ Njësia Administrative Frakull
➤ Njësia Administrative Libofshë
➤ Njësia Administrative Portëz
➤ Njësia Administrative Qendër
➤ Njësia Administrative Topojë
➤ Njësia Administrative Mbrostar-Urë
➤ Njësia Administrative Dërmenas
➤ Njësia Administrative Levan

Përfaqësues ligjor i institucionit **Armando Subashi**
Kryetar i Bashkisë Fier | Email: info@bashkiafier.gov.al

Personi i kontaktit **Arjon Avdiaj** – NJA Cakran
Cel.: 00355 68 62 75 606 | Email: njesiaadmcakran@gmail.com
Ermal Cekaj – NJA Frakull
Cel.: 00355 68 57 03 936 | Email: ermal.cekaj07@gmail.com
Fabjola Vallja – NJA Libofshë
Cel.: 00355 69 72 12 104 | Email: njesiaadministrativelibofshe@gmail.com
Elisabeta Elmazi – NJA Portëz
Cel.: 00355 68 87 73 005 | Email: elmazielisabeta@gmail.com
Edmond Mile – NJA Qendër
Cel.: 00355 69 55 30 407 | Email: edmondmile@gmail.com
Shpëtim Durraj – NJA Topojë
Cel.: 00355 69 47 96 672 | Email: shpetimdurraj@gmail.com
Fjona Dhima – NJA Mbrostar
Cel.: 00355 69 20 21 993 | Email: [komunambrostar@yahoo.com](mailto:komonambrostar@yahoo.com)
fjona.dhima@bashkiafier.gov.al

Mbulimi gjeografik Bashkia Fier dhe Njësitë Administrative

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2014

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
 - Të kryejë verifikimin e gjendjes ekonomike dhe sociale të individëve dhe familjeve në nevojë, me qëllim përzgjedhjen e tyre për ofrimin e ndihmës ekonomike.
- **Fushat e shërbimeve**
 - Shërbime sociale
 - Shërbime administrative
- **Llojet e shërbimeve**
 - Shërbime sociale:
 - Vlerësim, identifikim dhe referim i përfituesve në skemat e ndihmës sociale.
 - Informim dhe këshillim rreth të drejtave dhe mundësive për përkujdesje sociale.
 - Referimi i rasteve pranë Grupit Teknik Ndërsektorial, Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki.
 - Shërbime të tjera lehtësuese për kryefamiljarët në nevojë.
 - Shërbime administrative:
 - Mbështetje në procesin e aplikimit për përfitim të ndihmës ekonomike.
 - Regjistrim për përfitim të ndihmës ekonomike për mbrojtje me vendim gjykatë.
 - Regjistrim për përfitim pagese për paraplegjikë, tetraplegjikë, në raste të verbërisë dhe pagesë kujdestarie për këto tri kategori.
 - Mbështetje në procesin e aplikimit për përfitim të kompensimit të energjisë elektrike për paraplegjikët, tetraplegjikët, të verbërit, etj.

GRUPET PËRFITUESE

- **Kategoritë përfituese**
 - Familjet
 - Fëmijët
 - Individët
- **Kriteret kualifikuese**
 - Familje në kushte të vështira ekonomike
 - Individë të paaftë për punë
 - Fëmijë në kujdestari
 - Persona me aftësi të kufizuar dhe personat e verbër
 - Persona me urdhër mbrojtjeje nga gjykata (gra, fëmijë, të moshuar, etj.)
 - Aplikimi i sistemit të pikëzimit për përfitim të ndihmës ekonomike (*Personat me urdhër mbrojtjeje përfitojnë automatikisht ndihmë ekonomike pa kaluar në sistemin e pikëzimit.*)

Identifikimi i përfituesve

Përmes:

- Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Fier
- Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashki
- Referimeve nga zyra e punës, Fier
- Referimeve nga Gjykata
- Paraqitjes pranë Njesisë Administrative

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- Zyra sociale në çdo Njësi Administrative ka nga një administrator social.

Financuesi i shërbimit

- Bashkia Fier

Burime të tjera të ardhurash

- Nuk ka

Pagesa nga përfituesit

- Nuk ka

Koordinimi me shërbime të tjera

- Me shërbimet e listuara tek "Identifikimi i përfituesve"
- Posta Shqiptare

○ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Fier

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga “Vasil Peçuke”, Lagjja “Kastrioti”, Fier

Përfaqësues ligjor i institucionit **Armand Naçi**
Cel.: 00355 69 27 29 778 | Email: armand.naci@sherbimisocial.gov.al

Personi i kontaktit **Armand Naçi**
Cel.: 00355 69 27 29 778 | Email: armand.naci@sherbimisocial.gov.al

Mbulimi gjeografik Qarku Fier (*Bashkia Fier, Lushnjë, Mallakastër, Divjakë, Patos, Roskovec*)

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 1993

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

○ **Qëllimi i shërbimit** ➤ Të rrisë cilësinë e jetës për personat dhe grupet vulnerabël në qarkun Fier.

○ **Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbime shoqërore (përmes institucioneve të përkujdesjes sociale)
➤ Shërbime të pagesave të Ndhmës Ekonomike dhe Aftësisë së Kufizuar

○ **Llojet e shërbimeve** Shërbime shoqërore (Institucione të përkujdesjes sociale):
➤ Monitorim i standardeve të shërbimeve sociale në rajon të ofruara nga Institucionet e Përkujdesjes Sociale, publike dhe jopublike, rezidenciale dhe ditore që ofrojnë shërbime për fëmijët, të rinjtë, nënat e reja, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar.

Shërbime të pagesave të skemave për përkujdesje sociale:

- Administrim të Regjistrat Elektronik për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- Programim dhe detajim të fondeve për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar.
- Programim dhe shpërndarje e bonusit të foshnjës.
- Shqyrtim dhe përzgjedhje e rasteve të dhunës në familje ndaj grave dhe fëmijëve për mbështetje financiare.
- Shqyrtim dhe përzgjedhje e rasteve të viktimave të trafikut për mbështetje financiare (9,900 Lek/muaj).

Shërbimet e monitoruara nga DRSHSSH Fier

Shërbimet sociale për fëmijët:

- Shërbime ditore për fëmijë (1 qendër)
- Shërbime ditore komunitare (2 qendra)

Shërbime për personat me aftësi të kufizuar:

- Shërbime ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara (1 qendër)

Shërbime sociale për të moshuarit:

- Shërbime rezidenciale për të moshuarit (1 qendër)

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Familjet
- Viktimat e trafikimit
- Viktimat e dhunës në familje
- Personat me aftësi të kufizuara
- Të moshuarit

Kriteret kualifikuese

Familjet:

- Persona të papunë në moshë madhore
- Familje me të ardhura të pamjaftueshme
- Familje me foshnja të porsalindura

Fëmijë dhe të rinj:

- Të vendosur në familje kujdestare me vendim gjykate
- Të pa vendosur në institucion
- Që i kanë humbur të dy prindërit
- Me atësi të panjohur

Viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje:

- Viktima të trafikimit që kanë dalë nga qendrat kombëtare të strehimit të viktimave të dhunës dhe trafikimit.
- Viktima të dhunës në familje që përfitojnë pagesë bazuar në vlefshmërinë e urdhrin të mbrojtjes.

Personat me aftësi të kufizuar:

- Persona të verbër dhe persona para dhe tetraplegjikë
- Rezidentë të qarkut Fier

Të moshuarit:

- Të moshuar të vetmuar
- Të moshuar pa të ardhura që nuk zotërojnë tokë (potencialë për t'u vendosur në rezidencë)

Identifikimi i përfituesve

Përmes:

- Shërbimeve publike të përkujdesjes dhe mbështetjes sociale në rajon
- Administratorëve shoqërorë të njësive administrative
- Kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor
- Verifikimeve në terren të punonjësve socialë

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 21 punonjës

Financuesi i shërbimit

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Burime të tjera të ardhurash

- Nuk ka

Pagesa nga përfituesit

- Nuk ka

Koordinimi me shërbime të tjera

- Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Fier
- Njësitë Administrative për përfituesit e ndihmës ekonomike
- Shërbimet shëndetësore dhe Komisioni Mjekësor për Caktim të Aftësisë për Punë të Invalidëve (KMCAPI)
- Drejtoria Rajonale e Punësimit, Fier
- Prefektura
- Organizata të shoqërisë civile
- Institucione publike dhe jo publike të cilat kanë në fokus target grupet në nevojë.

○ Njësia e Shërbimit Paliativ dhe Kimioterapisë, Spitali Rajonal Fier

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga “Çamëria”, Lagjja “1 Maji”, Godina Qendrore e Spitalit Rajonal

Përfaqësues ligjor i institucionit **Dr. Erblin Dollakaj**
Cel.: 00355 69 32 63 939

Personi i kontaktit **Anisa Pllaha**
Cel.: 00355 69 33 68 875 | Email: anisa.pllaha@shendetesia.gov.al

Mbulimi gjeografik Qarku Fier (*Bashkia Fier, Lushnjë, Mallakastër, Patos, Roskovec, Divjakë*)

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2018

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

○ **Qëllimi i shërbimit** ➤ Të lehtësojë dhe menaxhojë me dinjitet pasojat e sëmundjes në fazën terminale për pacientët dhe familjarët e tyre.

○ **Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbime shëndetësore (paliative dhe kimioterapi) në spital
➤ Shërbime psiko-sociale

○ **Llojet e shërbimeve** Shërbime shëndetësore:
➤ Trajtim paliativ për personat me diagnoza onkologjike në stadi të avancuar.
➤ Aplikim i skemave të kimioterapisë venoze, orale dhe të kombinuara.
➤ Shërbim monitorues i pasojave të sëmundjes dhe përkujdesje në klinikë.
➤ Rikontrolle periodike të pacientëve paliativë.

Shërbime psiko-sociale:
➤ Mbështetje emocionale dhe psikologjike e pacientëve dhe familjarëve të tyre.
➤ Informim i familjarëve për ecurinë e sëmundjes.

○ GRUPET PËRFITUESE

○ **Kategoritë përfituese** ➤ Popullata e qarkut Fier

Kriteret kualifikuese	➤ Persona me diagnozë onkologjike të referuar nga mjekët specialistë dhe ata të familjes. ➤ Pacientë mbi 14 vjeç ➤ Rezidentë në qarkun Fier
Identifikimi i përfituesve	Përmes: ➤ Mjekut specialist onkolog ➤ Mjekut të familjes

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve	➤ 4 punonjës (2 mjekë onkologë, 2 infermierë)
Financuesi i shërbimit	➤ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Burime të tjera të ardhurash	➤ Nuk ka
Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka
Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Shëndetësor Parësor ➤ Poliklinika e Specialiteteve, mjekët onkologë ➤ Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë

O Qendra e Ndhmës Juridike Parësore, Fier

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga "Ramiz Aranitasi", Lagjja "Kastrioti", Nr. 15, Fier
(Në godinën e Këshillit të Qarkut, Kati i I)
Cel.: 00355 69 67 66 109 | Email: ndihmajuridike.fier@drejtesia.gov.al

Përfaqësues ligjor i institucionit **Adelina Agolli**
Cel.: 00355 69 67 66 109 | Email: adelagolli45@gmail.com

Personi i kontaktit **Adelina Agolli**
Cel.: 00355 69 67 66 109 | Email: adelagolli45@gmail.com

Mbulimi gjeografik Qarku Fier (*Fier, Roskovec, Patos, Mallakastër, Divjakë dhe Njësitë Administrative përkatëse*)

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2021

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit** ➤ Të ofrojë qasje në drejtësi për të gjithë përmes shërbimeve juridike falas për shtetasit në vështirësi ekonomike.
- **Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbime të ndihmës juridike parësore
➤ Shërbime të ndihmës juridike dytësore
- **Llojet e shërbimeve**

Shërbime të ndihmës juridike parësore:
Shërbim ligjor që ofrohet për mosmarrëveshje që mund të zgjidhen pa ndërmjetësimin e gjykatës.

 - Informim i qytetarëve mbi sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor.
 - Orientim/këshillim i shtetasve mbi veprimet që duhet të ndërmarrin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre.
 - Hartim i shkresave zyrtare drejtuar institucionit me të cilin individi është në konflikt me qëllim zgjidhjen e problematikës
 - Ndërmjetësim për zgjidhje konfliktesh.

Shërbime të ndihmës juridike dytësore:
Shërbim ligjor që ofrohet kur mosmarrëveshjet zgjidhen përmes gjykatës.

 - Përfaqësim me avokat falas në çështjet gjyqësore.
 - Përfundim nga pagesat e tarifave të shpenzimeve gjyqësore.
 - Përfundim nga tarifa për ekzekutim të vendimit nga shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror.

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
 - Popullata e qarkut Fier
- Kriteret kualifikuese**
 - Banues në qarkun Fier
 - Person me të ardhura të pamjaftueshme, pa pasuri të paluajtshme.
 - Viktimë e dhunës në familje, abuzimit seksual apo trafikimit.
 - Të mitur/fëmijë në konflikt me ligjin, që jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, etj.
 - Persona me aftësi të kufizuara, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, të cilëve u është cënuar e drejta përmes veprimeve diskriminuese.
- Identifikimi i përfituesve**
 - Përmes:
 - Paraqitjes pranë qendrës
 - Referimit nga institucionet vendore koordinuese (sikundër listuar më poshtë)

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
 - 1 jurist
- Financuesi i shërbimit**
 - Ministria e Drejtësisë, Shqipëri
- Burime të tjera të ardhurash**
 - Nuk ka
- Pagesa nga përfituesit**
 - Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Bashkitë Fier, Roskovec, Patos, Mallakastër, Divjakë
 - Njësitë Administrative në Bashkitë më sipër
 - Gjykata/Prokuroria Fier
 - Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Fier
 - Zyra e punës, Fier
 - Drejtoria Vendore e Policisë Fier
 - Qendra Horizont
 - Qendra psiko-sociale Vatra
 - Institucione të tjera publike dhe organizata të shoqërisë civile lokale dhe kombëtare

Qendra Komunitare Multifunkionale, Bashkia Fier

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga "Kujtim Majaci", Blloku i Banesave Sociale, Fier

Përfaqësues ligjor i institucionit **Arbër Agalliu**
Cel.: 00355 68 85 14 552 | Email: arbriagalliu@yahoo.com

Personi i kontaktit **Arbër Agalliu**
Cel.: 00355 68 85 14 552 | Email: arbriagalliu@yahoo.com

Mbulimi gjeografik Bashkia Fier (bashkë me 13 njësitë administrative (9 rurale dhe 4 urbane))

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2020

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

- Të sigurojë shërbime me bazë komunitare për fëmijët, të rinjtë, familjet dhe komunitetin.

Fushat e shërbimeve

- Shërbime sociale
- Shërbime edukimi

Llojet e shërbimeve

Shërbime sociale:

- Menaxhim multidisiplinar i familjeve në nevojë me ushqime, veshmbathje dhe elektroshtëpiake të domosdoshme.
- Këshillim psikologjik individual dhe në grup për fëmijët, të rinjtë dhe prindërit e tyre.
- Aktivitete për promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për (mbrojtjen e fëmijëve, të drejtat e fëmijëve, dhunën me bazë gjinore, etj.).
- Fuqizim i të rinjve nëpërmjet aktiviteve, trajnimeve dhe workshop-eve.

Shërbime edukimi:

- Program i aftësisimit prindëror për prindërit e rinj
- Mbështetje passhkollore, ditore (orari 14:00 - 17:00; grupmosha 6-18 vjeç)

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Të rinjtë
- Gratë
- Familjet

Kriteret kualifikuese	➤ Fëmijë të moshave 6-12 vjeç nga familje me probleme ekonomike dhe sociale ➤ Të rinj të papunë në kushte të vështira ekonomike dhe në nevojë për mbrojtje ➤ Gra të dhunuara dhe me urdhër mbrojtjeje ➤ Familje me vulnerabilitet të lartë ekonomik dhe social
Identifikimi i përfituesve	Përmes: ➤ Bashkisë Fier ➤ Njësi Administrative ➤ Shkollave ➤ Zyrës së punës, Fier ➤ Punës në terren të stafit të qendrës

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve	➤ 4 punonjës (1 menaxher, 1 punonjës social, 1 mësues passhkollor, 1 sanitar)
Financuesi i shërbimit	➤ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (përmes fondit social që administrohet nga Bashkia Fier)
Burime të tjera të ardhurash	➤ Terres des Hommes
Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka
Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Shërbimi Social në Bashki ➤ Njësitë Administrative ➤ Shkollat ➤ Zyra e punës, Fier

○ Shtëpia e të Moshuarve – Shërbim rezidencial kombëtar

Lloji i institucionit	Publik, kombëtar
Adresa	Lagja “Liri”, Rruga “Jakov Xoxa”, Nr. 142, Fier
Përfaqësues ligjor i institucionit	Dorina Gjino Cel.: 355 69 61 18 919 Email: dorina.gjino@yahoo.com
Personi i kontaktit	Eneida Balla Cel.: 355 68 55 00 005 Email: eneidaballa4@gmail.com
Mbulimi gjeografik	Kombëtar
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 1960

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
 - Të mundësojë një jetë dinjitoze për të moshuarit e vetmuar.
- **Fushat e shërbimeve**
 - Shërbime rezidenciale
 - Shërbime shëndetësore dhe infermierore në rezidencë
 - Shërbime psiko-sociale në rezidencë
- **Llojet e shërbimeve**
 - Shërbime rezidenciale për të moshuarit:
 - Rezidencë për të moshuarit (ushqim, fjetje, kujdes higjieno-sanitar për të moshuarit)
 - Shërbime shëndetësore dhe infermierore në rezidencë:
 - Monitorim i gjendjes shëndetësore, kronike ose jo
 - Konsulta nga mjeku i përgjithshëm për të moshuarit rezidentë
 - Rekomandime mjekësore
 - Analiza dhe ekzaminime sipas nevojës
 - Kujdes dhe shërbim dentar falas
 - Monitorim i sëmundjeve kronike, injeksione, mjekim plagësh, dhënie medikamentesh
 - Shërbime psiko-sociale:
 - Mbështetje emocionale dhe psikologjike sipas nevojave
 - Biseda dhe diskutime individuale apo në grup për shqetësime të moshës
 - Aktivitete socializuese dhe argëtuese
 - Shoqërim për nevoja jashtë institucionit
 - Asistencë për shërbimet funerale

GRUPET PËRFITUESE

- **Kategoritë përfituese**
 - Persona mbi 65 vjeç
- **Kriteret kualifikuese**
 - Të moshuar të paaftë për t'u kujdesur për veten
 - Të moshuar të vetmuar pa përkujdesje të familjarëve
 - Të moshuar pa strehim
 - Të moshuar pa mundësi financiare
 - Të moshuar me aftësi të kufizuara
- **Identifikimi i përfituesve**

Përmes:

 - Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashki (në çdo bashki të Republikës së Shqipërisë)
 - Shërbimit Social Shtetëror (Kombëtar)
 - Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Fier

INFORMACION ADMINISTRATIV

- **Numri i punonjësve**
 - 28 punonjës (1 drejtues, 1 shef finance, 1 përgjegjës sektori social, 4 mjekë të përgjithshëm (me kohë të pjesshme), 4 infermierë (me kohë të pjesshme) 5 kujdestarë socialë (me licencë infermierie), 8 sanitarë, 3 kuzhinierë, 1 mirëmbajtës).
- **Financuesi i shërbimit**
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **Burime të tjera të ardhurash**
 - Donatorë dhe OJF
 - Biznese private
- **Pagesa nga përfituesit**
 - Të moshuarit rezidentë paguajnë 40% të pensionit
- **Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Fier
 - Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Fier
 - Shërbimi shëndetësor parësor e spitalor
 - Spitali Memorial
 - Klinika Turke Turk-Dental
 - Kisha Ungjillore
 - Metropolia e Fierit dhe Apollonisë
 - Shkollat publike dhe jo-publike
 - Biznese private me aktivitet në Fier (Lion Club Apolonia, Rotary Club Albania, Eco Soft, Agjencia turke TIKa, etj.)

○ Qendra Horizont - Shërbime për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi ndryshe

Lloji i institucionit Publik

Adresa Lagjja "16 Prilli", Rruga "Llukan Toska", Fier
Cel.: 00355 69 81 54 769

Përfaqësues ligjor i institucionit **Enri Lulaj**
Cel.: 00355 69 33 52 462 | Email: enrilulaj@gmail.com

Personi i kontaktit **Enri Lulaj**
Cel.: 00355 69 33 52 462 | Email: enrilulaj@gmail.com

Mbulimi gjeografik Qarku Fier (*Bashkia Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër, Divjakë*)

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2015

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

○ Qëllimi i shërbimit

➤ Të përmirësojë cilësinë e jetës për personat me aftësi ndryshe dhe t'u mundësojë një jetë të pavarur.

○ Fushat e shërbimeve

- Shërbime terapeutike
- Shërbime psiko-sociale
- Shërbime të arsimit special

○ Llojet e shërbimeve

- Psikoterapi, logopedi dhe fizioterapi për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, moshë 3-19 vjeç.
- Informim dhe edukim i familjarëve rreth problematikave dhe ecurisë shëndetësore të fëmijëve dhe të rinjve.
- Mbështetje psiko-sociale për fëmijët e të rinjtë përfitues të shërbimeve.
- Arsimit special për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, moshë 3-19 vjeç.
- Transport dhe një vakt ushqimor për përfituesit.

○ GRUPET PËRFITUESE

○ Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Të rinjtë

○ Kriteret kualifikuese

- Fëmijë dhe të rinj me aftësi ndryshe të moshës 3-19 vjeç
- Mbajtës të vërtetimit për aftësinë e kufizuar me diagnozën përkatëse
- Përfshihen rastet shumë të rënda, siç janë personat tetraplegjikë që nuk kanë aftësi të lëvizin asnjë gjymtyrë.

● Identifikimi i përfituesve	Përmes: ➤ Qendrave Shëndetësore ➤ Njësive administrative ➤ Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social në Bashki ➤ Fushatave të ndërgjegjësimit në komunitet
● INFORMACION ADMINISTRATIV	
● Numri i punonjësve	➤ 29 punonjës (1 drejtor, 1 asistent, 2 punonjës administrative, 2 psikologë, 2 logopedë, 3 punonjës socialë, 4 fizioterapeutë, 8 mësues, 2 shoferë, 2 kuzhinierë, 2 sanitarë)
● Financuesi i shërbimit	➤ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (buxheti administrohet nga Bashkia Fier)
● Burime të tjera të ardhurash	➤ Nuk ka
● Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka
● Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social, Bashkia Fier ➤ Qendra Sociale Murialdo ➤ Qendra e Formimit Profesional, Fier ➤ Zyra e Punës, Fier

○ Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Fier

Lloji i institucionit Humanitar

Adresa Rruga “Kastriot Muço”, Lagjja “29 Nëntori”, Fier, Shqipëri
Cel.: 00355 69 57 66 710 | Email: dega.fier@kksh.org.al
Website: www.kksh.org.al/
Instagram: [Kryqi i Kuq Shqiptar, Fier](#)
Facebook: [Kryqi i Kuq Shqiptar, Fier](#)

Përfaqësues ligjor i institucionit **Mimoza Celibashi**
Cel.: 00355 69 57 66 710 | Email: dega.fier@kksh.org.al

Personi i kontaktit **Mimoza Celibashi**
